



MANUALI PËR VOTIMIN ONLINE PËR ZGJEDHJET STUDENTORE
NË
UNIVERSITETIN E PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

E-VOTIMI

Përmbajtja

HYRJE.....	3
VOTIMI ONLINE.....	4
KUSHTET PËR VOTIM	4
SI TË VOTOHET	5
PËRFUNDIM	9

HYRJE

Pas shumë hulumtimeve si dhe të studimit të disa platformave, të cilat gjenden online, platforma të cilat mundësojnë votimin online, si p.sh. ajo e doodle, google form, etj., ne erdhëm në përfundim se: platforma e gatshme si ajo doodle është shumë e kushtueshme nëse vendosim ta shfrytëzojmë, kushton diku rreth 6 euro për student, ndërsa platformën që e posedon google, ajo e cila njihet si **google form** në lidhje me formën e votimeve online që i posedon, KQZ UP-ja ka testuar atë formë dhe ka parë se është e mundur që me atë platformë të kryhen zgjedhjet, mirëpo nuk kemi mundësi të vendosim kushtet e dëshiruara në atë platformë, të cilat janë të obliguara nga ne t'i vendosim. Kjo është arsyeja pse e kemi lënë anash edhe këtë platformë.

Ne si zyre kemi zhvilluar një modul për shkaqe sigurie dhe për shkak të kushteve më të favorshme, të cilat dalin nga rregulloret mbi zgjedhjet në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

Ky modul është zhvilluar në kuadër të SEMS (Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve), i cili ishte rekomanduar nga anëtarët e KQZ UP-së, duke evituar problemet eventuale si ato të sigurisë, të monitorimit dhe të besueshmërisë.

Në bazë të kushteve që përmendem më lart dhe në pamundësi të mbajtjes së zgjedhjeve të studentëve në formën klasike, u vendos që ato të mos mbahen në formën fizike, siç janë mbajtur çdo herë në Universitetin e Prishtinës.

VOTIMI ONLINE

KUSHTET PËR VOTIM


Të gjithë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte kanë të drejtë të marrin pjesë në votimin online:

- Pjesa për votim elektronik vlen për studentët të cilët kanë të regjistruar vitin e fundit akademik me dy semestrat përkatës;
- Studentët të cilët kanë diplomuar ose janë çregjistruar dhe kanë të mbyllur dosjen në SEMS nuk mund të votojnë;
- Studenti nuk mund të votojë më shumë se një herë. Ai mund të hedhë një votë për Këshillin Studentor si dhe një votë për Parlamentin e Studentëve;
- Studenti mund të votojë vetëm në Këshillin Studentor ose në Parlamentin d.m.th. njëherë nga ato dhe mund të procedojë tutje;

SI TË VOTOHET

Studentët do të mund të qasen në linkun zyrtar, i cili do të publikohet në uebin e Universitetit të Prishtinës www.uni-pr.edu, ose drejtpërdrejt në këtë link <https://e-votimi.uni-pr.edu/> me të njëjtat kredenciale (përdorues dhe fjalëkalim) të cilat i posedon në <https://studenti.uni-pr.edu/>

Studenti, për të votuar, duhet të hyjë me kredencialet e tij personale, duke shënuar ID-në dhe fjalëkalimin e SEMS-it.



The image shows a login page for the University of Prishtine 'Hasan Prishtina' e-voting system. At the top is the university's logo, a circular emblem with a sunburst and the text 'UNIVERSITETI I PRISHTINES' and 'UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINENSIS' around the perimeter, with '1970 MCMLXX' at the bottom. Below the logo, the text reads 'Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"' and 'e-VOTIMI (Zgjedhjet Studentore 2022)'. There are two input fields: 'Përdoruesi' (Username) and 'Password'. Below these is a reCAPTCHA section with a checkbox labeled 'I'm not a robot' and the reCAPTCHA logo. A yellow button below the reCAPTCHA says 'Përdorni kredencialet e SEMS-it për qasje!'. At the bottom is a red button labeled 'Qasja' (Login).

Fig. 1 Qasja në e-Votimi

Pas dhënies së saktë të ID-së dhe fjalëkalimit të studentit, do t'ju paraqitet forma vijuese si në fig. 2




Fig. 2 Hyrja në e-Votimi

Pas qasjes së suksesshme, studentit i paraqitet një njoftim në ballinën e sistemit, si ky më poshtë:




Fig. 3 Njoftimi se forma e votimit është aktive

Studenti duhet të klikojë mbi butonin e kaltër me mbishkrimin **Forma e votimit** dhe do t'i paraqitet forma se ku dhe për kënd ai dëshiron të votojë:




Fig.4 Forma e fletëvotimit

Studenti mund të zgjedhë për Këshillin Studentor ose për Parlamentin Studentor. Ai do të ketë mundësinë të zgjedhë vetëm njërin prej tyre (KS ose PS) ose për të dyja (KS dhe PS) dhe të vazhdojë tutje. Sistemi ia mundëson një gjë të tillë.




Fig. 5 Hedhja e votës

Pasi të klikojë mbi butonin Voto, studenti në këtë rast do të obligohet të hapë e-malin e tij zyrtar në gmail emri.mbiemri@student.uni-pr.edu dhe të marrë kodin e kërkuar për t'iu mundësuar votimi. Ai këtë do ta bëjë në kohën e kufizuar prej 10 (dhjetë) minutave. Nëse studenti nuk ia del brenda këtyre minutave të sjellë kodin e kërkuar në formën, e cila është paraqitur në fig. 6, ai

duhet të qaset përsëri në hapat më lart dhe sërish do t'i rigjenerohet kodi tjetër, i cili i dërgohet në e-mail.



Fig. 6 Njoftimi i marrjes se kodit 6 shifror




Fig. 7 Kodi 6-shifror

Studenti e bart kodin nga e-maili në tabelën më poshtë dhe procedon me votimin.




Fig. 8 Vendorsja e kodit 6-shifror

Studenti duhet të klikojë mbi butonin Verifiko dhe me këtë procedurë vota e tij do përfundojë dhe do t'i paraqitet njoftimi ***"Vota juaj është e fshehtë dhe e garantuar. Faleminderit për votim"***.

Nëse studenti e rifreskon faqen apo kthehet prapë në faqen e njëjtë, do t'i njoftohet që ka votuar si dhe do t'i paraqitet vota e tij në Hash dhe e enkriptuar siç është paraqitur në figurën më poshtë.



Fig. 9 Vota në Hash dhe e enkriptuar

Studenti më pastaj mund të krahasoj këtë vlerë me listën e votave në Hash dhe të enkriptuar që do të shfaqet për secilin kandidatë. Me këtë senatori siguron integritetin e votës, pra që vota e tij është numëruar ashtu siç ai ka votuar.

Gjithashtu këtu njoftohet studenti se më nuk mund të votojë dhe se ai e ka përfunduar votimin e tij.

Nëse studenti dëshiron prapë të votojë, kthehet prapë në faqen e njëjtë në linkun më lart, ku do t'i paraqitet ky njoftim si në këtë formë (që nuk lejohet të votojë përsëri).




Fig. 10 Njoftimi se keni ushtruar njëherë të drejtën e votës

Me këtë njoftohet studenti se më nuk mund të votojë dhe se ai e ka përfunduar votimin e tij.

PËRFUNDIM

Besojmë se me këtë platformë Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" do të marrë një hap shumë të rëndësishëm në transparencën, në sigurinë si dhe në cilësinë e zgjedhjeve të studentëve, jo vetëm në kohën e COVID-19, por edhe në vitet e ardhme, ku kjo platformë do të kryejë një punë më të shpejtë, më pak të kushtueshme, si për studentët ashtu edhe për vetë buxhetin e UP-së.